



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më .05.2026

**MBLEDHJA Nr. 22,
Datë 13.05.2026, ora 12:00
e Bordit të ERE-s.**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 13.05.2026, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr.22 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Prill 2026 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “KOKA & ERGI ENERGY PESHK” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
4. Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik.
5. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI